



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 24.10.2019

Dokument parlamentar

RAPORT

**PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS PRANVERA STRAKOSHA KOMISIONER PËR
MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e datës **24 tetor 2019**, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në bazë të Rregullores së Kuvendit, neneve 27, 32-38 dhe 111 të saj zhvilloi procedurat parlamentare për seancën dëgjimore dhe shqyrtimin e të vetmes kandidaturë të vetë ofruar për detyrën e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Komisioni caktoi relator anëtarin e komisionit z. Alket Hyseni.

Në Kuvend është depozituar një kandidaturë e vetofruar pas shpalljes së bërë publike në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë për Komisioner për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil si më poshtë:

1. Znj. Pranvera Strakosha

Kandidaturë kjo që është mbështetur me firma nga jo më pak se **28** deputetë.

Baza kushtetuese dhe ligjore e propozimit

Si bazë ligjore e propozimit të mësipërm kanë shërbyer përcaktimet kushtetuese, ligjore dhe proceduriale si më poshtë:

- Parimet e pavarësisë së nëpunësve publikë civilë dhe garancia e qëndrimit në detyrë përcaktohen në Kushtetutë.

Neni 107 i Kushtetutës parashikon se:

“1.Nëpunësit publikë zbatojnë ligjin dhe janë në shërbim të popullit. 2. Nëpunësit në administratën publike caktohen me konkurs, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji. 3.Garancitë e qëndrimit në detyrë dhe trajtimi ligjor i nëpunësve publikë rregullohen me ligj”

- Zgjedhja e Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil bazohet në ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, në nenin 12 të tij, i cili parashikon se:

" I . Komisioneri zgjidhet nga Kuvendi, për një qfat 5-vjeçar, me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë"

Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të organeve të pavaruara

Procedura për zgjedhjen e anëtarëve të organeve të pavarura të krijuara me ligj, kur nuk parashikohet në ligjin organik, është e rregulluar në nenin 111 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni i Ligjeve zhvilloi seancën dëgjimore me një kandidaturë të propozuar. Seanca dëgjimore u zhvillua në bazë të nenit 111, pika 6 e Rregullores së Kuvendit.

Zonja Pranvera Strakosha prezantoi përpara anëtarëve të komisionit, veprimtarinë e saj dhe përvojën në detyrën e ushtruar si Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil. Gjithashtu ajo paraqiti edhe vizionin e saj për në vazhdim për drejtimin e këtij institucioni.

Anëtarët e Komisionit të Ligjeve si dhe të gjithë deputetët prezent i drejtuan pyetje kandidates për të krijuar një mendim të plotë dhe të drejtë për vlerësimin e kandidaturës.

Pas përfundimit të seancës dëgjimore me kandidaturën, relatori i komisionit z. Alket Hyseni. relatoi lidhur me përmbushjen e kriterëve ligjore dhe të meritës së kandidaturës.

Kandidatja Pranvera Strakosha, juriste, ka një përvojë profesionale mbi 10 vjeçare. Ajo ka qënë pjesë e sistemit gjyqësor, si gjyqtare dhe zëvendëskryetare e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe ka qënë e zgjedhur nga Kuvendi si anëtare e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Më pas znj. Strakosha ka vijuar veprimtarinë e saj profesionale si avokate dhe konsulente ligjore në fushat e së drejtës administrative. Me Vendimin e Kuvendit nr. 85/2014 datë 30.10.2014 Zonja Pranvera Strakosha është zgjedhur si Komisioner për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

Komisioni vlerëson se kandidatura e zonjës Pranvera Strakosha plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 12 dhe 21, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, si dhe kriteret e papajtueshmërisë me funksionin Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Gjithashtu, Komisioni gjykon se kjo kandidaturë plotëson kriteret e meritës profesionale për ushtrimin e funksionit të propozuar.

Për këto arsye, Komisioni e miratoi, me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm në mbledhje, propozimin për zgjedhjen e zonjës Pranvera Strakosha si Komisioner për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe ia paraqet seancës plenare për votim.

KRYETARI

Ulsi MANJA

RELATOR

Alket HYSENI